

20141163585

**LIGJ PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TË OBLIGIMEVE SIPAS
MARRËVESHJES PËR HUA PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR
REHABILITIMIN E RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE, QË DO TË LIDHET
NDËRMJET BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM-
BANKËS BOTËRORE DHE NDËRMARRJES PUBLIKE PËR RRUGË
SHTETËRORE**

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton përmbushjen e obligimeve dhe plotësimin e dispozitave të Marrëveshjes për hua për financimin e Projektit për rehabilitimin e rrugëve rajonale dhe lokale, që do të lidhet ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Bankës Botërore dhe Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore në shumë prej 52 000 000 euro, në afate dhe kushte të parapara në Marrëveshjen për hua, nëse Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore nuk i plotëson dhe servison obligimet nga Marrëveshja për hua.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji përcaktohen në Marrëveshjen për hua, që do të lidhet ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Bankës Botërore dhe Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore për financimin e Projektit për rehabilitimin e rrugëve rajonale dhe lokale.

Neni 3

Të gjitha obligimet që rezultojnë nga Marrëveshja e për hua nga neni 1 i këtij ligji, si dhe servisimin e huas do t'i kryejë Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore nga të hyrat që i realizon, në afate dhe kushte të përcaktuara në Marrëveshjen për hua.

Neni 4

Afati i pagesës së huas nga neni 1 i këtij ligji është 23 vite, me grejs periudhë të përfshirë prej 6 vitesh.

Shkalla e kamatës është EURIBOR gjashtëmuor plus shtrirja variabile.

Në ditën e tërheqjes së mjeteve të huas, Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Bankës Botërore provizion të njëhershëm në shumë prej 0,25% të shumës së huas.

Huaja do të paguhet në 34 këste gjysmëvjetore, në çdo 15 tetor dhe 15 prill të vitit.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella që rezultojnë nga Marrëveshja për hua dhe Marrëveshja për garanci, Ministria e Financave dhe Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".